



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:248686  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05765682

**C.nr.2655/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Y.B. nga Komuna P., të cilin e përfaqëson F.M., avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S..”, me seli në ., me bazë juridike kompensim dëmi nga autopërgjegjësia, vlera e kontestit 1000 euro, jashtë seance, me datën 31.05.2024 mori dhe përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET e tërhequr** padia e paditësit Y.B. nga Komuna P., e parashtruar me datë 05.11.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S..”, me seli në P., me bazë juridike kompensim dëmi nga auto-përgjegjësia, vlera e kontestit 1000 euro.

**II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësi Y.B., përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S..”, me seli në P., me bazë juridike kompensim dëmi nga auto-përgjegjësia, vlera e kontestit 1000 euro.

Gjykata, me datën 24.05.2024 ka pranuar parashtrësës e paditësit, përkatësisht nga i autorizuari i tij, me anë të së cilës parashtrësë, ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës me arsyetim se për këtë çështje kontestimore kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës,

rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2655/21, me datë 31.05.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.